



KOMUNA E NOVOBËRDËS - OPŠTINA NOVO BRDO  
DALËSE - IZLAZNA  
nr/str 01-577  
Në/Datë 22.10.2019  
NOVOBËRDË - NOVO BRDO

## Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosova  
Komuna e Novobërdës  
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo



### KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

Anëtarit të Kuvendit Komunal të Novobërdës  
Z/znj \_\_\_\_\_

Në bazë të dispozitave të nenit 43 pika 43.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale si dhe në bazë dispozitave të nenit 36 të Statutit të Komunës së Novobërdës.

### FT O J

Mbledhjen e dhjetë të rregullt të Kuvendit Komunal e cila do të mbahet më datë: 31.10.2019 (e enjte) duke filluar në ora 10:00.

### R e n d i i d i t ë s

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K-së;
2. Prerja e vendimit për bartjen e mjeteve nga kodi buxhetor i zyres së Kryetarit në kodin buxhetor Sherbime Komunale në vlerë prej 15%;
3. Raportim nga Drejtoria e Arsimit rreth transportit të nxënësve dhe bursave për nxënës dhe student;
4. Raport rreth memorandumeve të nënshkruara në mesë të Komunës dhe Hidromoraves (për ujësjellësin në Koretishtë-Pasjak);
5. Raport nga Drejtoria e Sherbimeve Publike, në lidhje me një numër të madhë të kërkesave të qytetarëve të dorëzuara në Drejtori dhe rreth perfundimit të rrugës në fshatin Pasjak;
6. Të ndryshme.

Mbledhja do të mbahet në lokalet e K.K-së, së Novobërdës.

Më: 22.10.2019  
Në: Novobërdë



Nebojsa Arsic  
Kryesues i Kuvendit

*(Handwritten signature)*



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**  
**Komuna e Novobërdës**  
**Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo**



---

**KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY**

---

**PROCESVERBAL**

Nga mbledhja e parë e jashtzakonshme e Kuvendit të Komunës së Novobërdës e mbajtur më datë 26.09.2019, duke filluar në orën 10:05.

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesi Nebojsa Arsic, zv.Kryesuesi Ramush Mehmeti, anëtarët e Kuvendit: Ivica Cenic, Mirjana Simijonovic, Jorgovanka Filic, Dragana Dimic, Abdyl Gashi, Negovan Jovanovic, Milica Jovanovic, Selatin Nuhui, Dobriboje Djordjevic, Xhejlane Behluli, Zymer Zymeri, Drejtori i Administratës Driton Abdyli, Drejtori i Financave Sercan Todorovic, përfaqësuesi i OSBE-es, zyrtar komunal dhe qytetarë.

Kryesuesi i Kuvendit Nebojsa Arsic pasi përshendeti të pranishmit tha: para se të fillojmë me mbledhjen duhet konstatuar korumin prezent janë 13 antarët të Kuvendit nga 15 gjithësej, kemi korum për punë dhe vendimarrje dhe po fillojmë mbledhjen me këtë:

**R e n d d i t e**

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K-së;
2. Aprovimi i Buxhetit për vitin 2020-2022;
3. Të ndryshme.

Kryesuesi tha pasi që është mbledhje e jashtzakonshme nuk kemi mundësi të plotësojmë ose ndryshojmë rendin e ditës por vetëm duhet të aprovohet dhe e hudhi në votim rendin e ditës.

Aprovohet njëzëri nga të gjithë antarët prezent të Kuvendit.

**Pika e parë:** Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K;

Kryesuesi tha: ju kërkoj falje që procesverbalin e keni marrë me vonë, por e dini edhe ju që nuk kemi pasur kohë që ta pregadisim më herët si dhe deri sa është perkthyer është vonuar por keni pasur pak kohë që ta lexoni, nese keni ndonjë vërejtje urdhëroni.

Pasi nuk pati vërejtje aprovohet procesverbali njëzëri nga antarët të gjithë antarët prezent të Kuvendit.

**Pika e dytë:** Aprovimi i Buxhetit për vitin 2020-2022;

Kryesuesi tha: siç e dimë në mbledhjen e kaluar është terhequr kjo pikë nga rendi i ditës për arsye se Kryetari ka qenë në bisedime me Kryeministrin për disa projekte, 30 shtatori është afati i fundit që të dorzohet buxheti, për më shumë ja kaloj fjalën Drejtorit të financave Sercan Todorovic.

Sercan Todorovic pasi përshendeti të pranishmit tha: në bazë të qarkores buxhetore që na ka ardhur nga Ministria e Financave ne kemi pregaditur buxhetin si dhe në bazë të debateve publike që i kemi mbajtur. Buxheti në total për vitin 2020 është 3,075,633€, granti qeveritar është 2,843,154€, të hyrat vetanake janë 232,479€. Për paga dhe medita janë 2,328,196€, për mallra dhe shërbime 289,716€, për shpenzime komunale 70,000€, për subvencione dhe transfere janë 40,000€, për shpenzime kapitale janë 347,721, në material i keni për secilin Drejtor të ndarë nese keni ndonjë pyetje urdhëroni, ju faleminderit.

Kryesusi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Ramush Mehmeti pasi pershendeti të pranishmit tha: pika e aprovimit të buxhetit është një pikë shumë e ndishme duke pasur parasysh se kemi mbajtur debate publike me qytetarë dhe mundësit tona buxhetore janë shumë të vogla ndërsa kërkesat tona janë shumë të mëdha. Në bashkpunim me shumicën e antarëve të Kuvendit jemi munduar ti zgjedhim disa kërkesa që do të realizohen në projekte, por para se të shkojm te lista e projekteve kapitale unë e kam një propozim. Në kodin e Drejtorisë së zhvillimit ekonomik janë 4 puntorë drejtorja ka planifikuar për paga dhe meditje 40,000€, mendoj se është një buxhet shumë i madhë ky dhe propozoj që nga ky kod të terhiqen 10,000€ dhe të barten në kodin e Kuvendit në paga dhe meditje për arsye se ligji i pagave e rrit më së shumti koston e pagave të Kuvendit, po ashtu të kodi i mallrave dhe shërbimeve propozoj që të kodi i Kryetarit të terhiqen 3,000€ dhe të bareten në kodin e Kuvendit në mallra dhe shërbime, këto janë njëher propozimet tona dhe ti votojm janë vetëm për bartje të mjeteve prej një kodi në kodin tjetër, ju faleminderit.

Sercan Todorovic tha: po nderlidhem me zt.Mehmeti buxheti për paga dhe meditje është i planifikuar ashtu e nuk mundë të ndrrohet por në bazë të ligjit të pagave mundë të ndryshohet varësisht se ku ka rritje.

Ramush Mehmeti tha: nese mendon se nuk ndrrohet atëher e ki gabim, këto dy kode janë të dyshimta për këtë arsye po propozoj që të bëhet bartja, nese pajtoheni mirë ne e hudhim në votim ose nese ka i dëgjojm edhe propozimet tjera.

Kryesuesi tha: i hudhi në votim propozimet e Ramush Mehmetit.

Sercan Todorovic tha: ju Kuvendi keni të drejt ta apromoni ose jo buxhetin por jo ta ndrroni si dhe keto mjete të planifikuara janë të mjaftueshme për paga.

Ramush Mehmeti tha: mendoj se këtu ju nuk keni të drejt, jeni gabim ne jemi ata që e aprovojm buxhetin, kërkoj të hudhet në votim kalon në rregull nese nuk ka kalon ska asnjë problem.

Sercan Todorovic tha: nuk thash se ju nuk e apromoni buxhetin, ju keni të drejt ta apromoni ose jo e jo ta ndryshoni.

Zymer Zymeri pasi pershendeti të pranishmit tha: po habitem me Drejtorin që po thot se nuk keni të drejt vetëm se na çka të thojm, unë e perkrahi Ramush Mehmeti pasi që nuk është në rregull 4 puntor të paguhën 40,000€, jo çka të doni ju por çka të dojm edhe ne se ne këtu paguhemi 15 antarë, pse me votu ne kur nuk kemi të drejt asgjë.

Kryesuesi tha e hudhi në votim propozimin e Ramush Mehmetit për bartje të mjeteve nga kodi ekonomik paga dhe meditje prej Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik në zyre të Kuvendit në paga dhe meditje vlera prej 10,000€ dhe nga zyra e Kryetarit prej mallra dhe shërbime të barten në zyre të Kuvendit në mallra dhe shërbime në vlerë prej 3,000€.

Me 11 vota për, 2 nuk kanë votuar dhe 2 antarë nuk ishin prezent aprovohet ky:

#### VENDIM

Për aprovimin e buxhetit për periudhën 2020/22, me propozimin që në kategorinë e pagave dhe meditjeve në Drejtori e Zhvillimit Ekonomik kodi 1.10 nën programi 48030 të mirren 10,000€ dhe të barten në kodin 1.2 nën programin 16930 në zyre të Kuvendit Komunal në kategorinë paga dhe meditje.

Për aprovimin e buxhetit për periudhën 2020/22, me propozimin që në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve nga Zyra e Kryetarit kodi 1.1 nën programi 160 të mirren 3,000€ dhe të barten në kodin 1.2 nën programin 16930 në zyre të Kuvendit Komunal në kategorinë mallra dhe shërbime.

Ramush Mehmeti tha: sa i perket investimeve kapitale të gjithë e dim se nuk kemi mundësi dhe nuk kemi buxhet që ti realizojm të gjitha, por në bashkpunim me shumicën e antarëve të Kuvendit kemi diskutuar dhe kemi bërë një kalkulim tjetër ku propozoj kështu prej kodeve egzistuese të cilat i ka propozuar Kryetari dhe Drejtorja të mbesin ashtu por vetëm të bëhen disa ndryshime të vogla që do të thot të participimi në projekte prej shumë 68,957€ ta zvoglojm për 10,000€. Të asfaltimi i rrugëve i kemi 93,523€ edhe këtë shumë ta zvoglojm për 23,523€ të mbesin 70,000€. Gjithashtu kemi parapa që ti shtojm dy kode të reja buxhetore,

thurrja e varrezave të jetë një kod i ri buxhetor me një shumë simbolike prej 3523€ dhe në rast se rriten të hyrat vetanake të hyn në këtë kod pasi që kemi shumë kërkesa për thurje dhe mirëmbajtje të varrezave, poashtu të jetë edhe një kod i ri për perfundimin e fushes së sportit në Kufc, është një projekt që ka filluar atëher dhe ai projekt nuk është përfunduar ende dhe ka qenë kërkesa e qytetarëve dhe ka qenë kërkesa edhe këtu që ky projekt të përfundoj dhe kemi parap si kod buxhetor që të ndahet një shumë prej 30,000€, dmth kur i kemi zvogluar dy shumat lart janë barazu më këto kodet e reja. Në bazë të mundësive buxhetore që i kemi unë e kisha propozu një list të projekteve: afaltimi i rrugës në fshatin makresh i ultë 30,000€ buxhet është një shumë e vogël e di por të pakten të jetë një shumë që të filloj si projekt e të vazhdoj edhe viteve tjera, afaltimi i rrugës rabanaçki i ultë në dy rrugët ansore në fshatin Kufc në vlerë prej 30,000€, afaltimi i rrugës në fshatin Pasjak lagjja afer burgut në vlerë prej 5,000€, afaltimi i rrugës në fshatin Prekovic lagjja marinkovit në vlerë prej 10,000€ dhe afaltimi i rrugës në fshatin Prekovic Terinçami në vlerë prej 10,000€, ky është buxheti në total prej 70,000€ që e kemi për asfaltimin e rrugëve lokale. Të kodi i ndriqimit publik i kemi 30,000€ dhe i kemi këto propozime, ndriqimi në fshatin makresh i lartë në vlerë prej 5,000€, ndriqimi në fshatin Llabjan lagjja Hamdijaj, Stojkovit dhe Talaj rruga e parë në vlerë prej 5,000€, ndriqimi në fshatin Pasjak lagjja pas burgut vlera 5,000€, ndriqimi në Llabjan shkoll, haziraj, zeqiraj 5,000€, në fshatin Vllasaliu lagjja zymeraç 3,000€, lagja e parë brus vlera 2,000€ dhe koznic lagjja behja 3,000€. Të kodi thurrja e varrezave që është kodi i ri e kemi planifikuar thurrjen në fshatin Kosaq 3523€ dhe poashtu të kodi për mirëmbajtje të rrugës kemi planifikuar rregullim e rrugës në zhavor në lagjen hamdijaj deri të varrezat jo nga kodi i projekteve kapitale por nga kodi për mirëmbajtje të rrugëve. Ky është propozimi ynë e dim se është i paknaqshëm pasi që ka kërkesa shumë të mëdha.

Sercan Todorovic tha: po e pyes zt.Mehmeti se në çka është bazu që të ndahen këto proejkte në këto vlera, nuk mundë të ndodh kjo kështu si ka ndodhur në vitin e kaluar i keni ndar porejkte në shuma të caktuara pas bërë asnjë llogaritje dhe proejktet kan kushtuar më shumëe nuk ka pasur mundësi që të realizohen të gjitha. Në nuk mundë të ndertojm ndriqim publik në çdo vend pasi që pagesa e rrymes kushton shumë dhe ne nuk kemi mundësi që ti mbulojm të gjitha si dhe kemi borgje ende në pagesa të rrymes. Thurja dhe mirëmbajtja e varrezave nuk është e nevojshme vetem në Kosaq por në të gjithë teritorin e Komunës, i kemi edhe ne si Drejtori kërkesat që i kemi marrë nga qytetarët në degjime publike, këto propozime i bënë Kryetari dhe projektete duhet me qenë të përbashkëta.

Kryesuesi tha: sa i perket këtyre projekteve është një propozim i të gjithë kërkesave të qytetarëve që i kanë paraqit edhe në degjim publik që e kemi mbajtur këtu në sall të Kuvendit edhe ju keni qenë prezent Drejor, vetem ju e keni propozur rregullimin e nje rruge por ajo rrug nuk është në kataster.

Sercan Todorovic tha: ju i keni bojkutuar debatet, vetem znj.Xhejlane ka qenë në të gjithë debatet, edhe ne debate ne i kemi kërkesat tona.

Ramush Mehmeti tha: unë mendoj se çdo antarë ka të drejt me propozu. Ju drejtor keni qenë këtu në debat në këtë degjim publik dhe ju keni propozu këtë sallën në Kufc dhe ne po e perkrahim, po pajtohem që ka shumë kërkesa të arsyeshme por me këto mundësi që jan unë e kam dhënë propozimin mos të paragjykojm nese kalon në rregull.

Bajrush Ymeri pasi pershendeti të pranishmit tha: kerkoj mirëkuptim prej të gjithëve pasi që është një seancë e jashtzakonshme dhe e rëndësishme ka të bëjë me buxhetin i cili prek interesat e qytetarëve tonë, është mirë me diskutu secili me i dhënë mendimet e veta dhe pastaj me arrit një kompromis të përbashkët. Me një situat si kemi hyr nuk po na pelqen askujt, siç e don reni, rregulli dhe ligji fillojn procedurat qysh në muajin mars kur vjen qarkorja për hartimin e buxhetit dhe pastaj fillojnë diskutimet nga ekzekutivi, mbahen debatet publike me të gjitha sferat e jetes dhe me të gjithë qytetarët e Komunës, poashtu organizohen debate edhe nga Kuvendi sepse edhe ju jeni perfaqësues të qytetarëve dhe mbroni interesat e atyre qytetarëve të cilet ju kanë votuar dhe në fund ipen propozimet për investime kapitale sipas prioriteteve dhe rëndesisë së atyre projekteve, sepse është e pamundur më këtë buxhet 347,721€ sa ka Komuna jonë të realizohen të gjitha kërkesat dhe nevojat që kanë qytetarët, me këtë shumë nuk mundë të asfaltohet as një rrugë që disa her e kemi cek është rruga në fshatin Makresh të ulët. Unë vetem po ju kujtoj

ne në këtë sall kemi organizuar një debat me qytetar ku kanë marr pjesë perfaqësuesit e fshatrave dhe i kanë dhënë disa propozime si p.sh. për fshatin Pasjak perfaqësuesi Naser Ibrahim ka thënë: asfaltimi i rrugëve lokale në gjatësi prej 3.5km, ndriqimi publik në lagje të fshatit, ndertimi i kanalizimit të fshatit. Perfaqësuesi i fshatit Llabjan nuk ka qenë atë ditë këtu dhe i ka propozuar Fatosi: asfaltimi i disa pjesëve të rrugës së fshatit në gjatësi prej 2km, funksionalizimi i ujësjellësit, ndertimi i qerndhes për fëmij, ndriqimi publik në lagje të fshatit si dhe Drejtori i shkolles ka paraqitur kerkesat për shkollë. Për qendren e Novobërdës Rrahman Makolli ka propozuar: blerjen e një autoambulance për QKMF-në në Novobërdë, asfaltimi i rrugës të Lam-minera-koloni e vjeter, renovimi i QKMF-së në Novobërdë, asfaltimi i rrugës Boston-kisha sase-kala, ndertimi i trotuarit nga lagjja Mehmetaj deri të ndertesa e parë, ndertimi dhe rregullimi i ujësjellësit në kolonin e vjetër. Përfaqësuesi i fshatit Vllasali ka propozuar: asfaltimin e rrugëve lokale të fshatit, ndriqimi publik për lagjet e fshatit, zgjerimi i hapsirës për varreza, hapja dhe rregullimi i rrugës Vllasali-Marec-te xhamia, hapja dhe rregullimi i rrugës Vllasali-Izvor. Perfaqësuesi i fshatit Tullarë ka propozuar: asfaltimin e pjesëve të mbetura të rrugëve të fshatit 2km, ndriqimi publik, funksionalizimi i ujësjellësit, ndertimi i kanalizimit në lagjen Zejnaj, ndertimi me zhavor i dy rrugëve të dy palë varrezat e fshatit, thurja e varrezave të lagjes zejnaj, riparimi i urës së dëmtuar nga të reshurat të familja Selmani, perfaqësuesi i fshatit Makresh i ulët ka propozuar: asfaltimin e rrugës së fshatit, hapja dhe rregullimi i rrugës së familjes Sylejmani, ndertimin e kanalizimit, ndriqimin publik dhe funksionalizimin e ujësjellësit, për fshatin Stanishor, Kosaq dhe Kufc propozimet i ka dhënë perfaqësuesi i fshatit Stanishor Adem Isufi ku ka propozuar për Stanishor: asfaltimin e rrugëve të lagjeve të fshatit në gjatësi prej 1km, ndertimin e trotuarit për rreth rrugës së fshatit, ndriqimin publik, ujësjellësin për banorët e fshatit. Për fshatin Kosaq ka permendur: ndertimin e kanalizimit në të dy lagjet e fshatit, ndertimin e fushes së sportit, thurjen e varrezave në të dy lagjet e fshatit. Për fshatin Kufc e eperme ka permendur: asfaltimin e rrugës së fshatit në gjatësi prej 1km, ndertimin e trotuarit për rreth rrugës kryesore në gjatësi prej 1.5km dhe ndriqimin publik. Natyrisht këto kanë qenë kerkesat që kanë dal në këtë sall nga debati, ato që u permenden nga zv.Kryesusi në listen e tij ishin perfshi disa por natyrisht që nuk ka pasur mundësi të përfshihen të gjitha, ne jemi për të përkrahur çdo list e cila mbulon dhe rregullon të gjitha kerkesat e qytetarëve tonë por a është në rregull kjo formë?, nuk është sepse në Ligjin për Vetqeverisje Lokale është e cekur se kush e propozon buxhetin dhe kush pastaj duhet ta aprovoj por kemi ardhur në një situat dhe çdo list që vjen për të mirën e qytetarëve natyrisht se do ta perkrahmi gjithëmon, ju faleminderit.

Abdyl Gashi pasi pershendeti të pranishmit tha: në bashkpunim me të gjithë subjektet opozitare dhe asambleistat kemi arritur ti zgjedhim proejktet të cilat janë jetike për banorët. Mendoj dhe e perkrahi bindshëm bashk me disa asambleista që kemi pasur kontakt këto projekte dhe nuk pajtohem me Drejtorin i cili thot se nuk mundemi ta ndryshojm pasi që është e drejt themelore që të bëjm ndryshime, të paraqesim propozime. Kemi degjuar në debatin të cilin e ka organizuar Kuvendi propozimet e ndryshme që i kanë paraqitur qytetarët por duke pasur parasysh se propozimet kanë qenë të shumta për çdo fshat është problem që të bëjm zgjidhje për të gjithë, mendoj se opozita e Kuvendit është duke e bërë një punë shumë të mirë që është shembull jo vetem për Komunën tonë por edhe për Komuna të tjera sepse në një far forme po ja lehtësojm punën edhe qeveries, një paqartësi është permend nga qytetarët edhe një qerdhe në fshatin Llabjan unë e perkrahi pa kurfar hezitimi këtë projekt të cilin e propozoj Ramush Mehmeti.

Dobrivoje Djordjevic tha: këto fjalimet e juaja më teper po kuptohen si fushat zgjedhore, Ramush Mehmeti ka dhënë disa propozime por ne nese vazhdojm kështu nuk mundë të zgjedhim asgjë andaj kerkoj një pauz prej 5-10min që të konsultohemi dhe të sqarohet kjo, ne e dim se me këtë buxhet që e kemi për investime kapitale nuk kemi mundësi që ti realizojm të gjitha kerkesat.

Sercan Todorovic tha: propozimet që i kanë dhënë zv.Kryesuesi nuk janë të perfshira fshati Stanishor, Koretisht dhe Kufc dhe Pasjaki me disa projekte të vogla por këto fshatra janë zone e parë dhe tatim paguese më të mëdha andaj ju antarët keni kujdes se çka po votoni.

Mirjana Simijonovic pasi pershendeti të pranishmit tha: vetem ta pyes Drejtorin se për çfarë arsye nuk është Kryetari në mbledhje pasi që në mbledhjen e kaluar u shty kjo pikë për arsye se Kryetari nuk ishte

prezent dhe ne të gjithë po kemi dëshirë që edhe ai të marrë pjesë, si dhe pse ne nuk do duhej ti përkrahim propozimet kur ne të gjithë jemi antarë të Kuvendit dhe i votojmë të gjitha projektet për të gjithë qytetarët e Komunës edhe ne jemi që të rregullohet ujësjellësi, ndriqimi kanalizimi dhe të gjitha në të gjitha fshatrat, ne në Koretisht e kemi problemin me ujësjellës.

Ramush Mehmeti tha: unë po pajtohem me diskutimet e parafolëseve të mi, ne po e dim shumë mirë se me këtë buxhet nuk kemi mundësi as rrugën e makreshit ta perfundojmë, por ne po themi që të kemi kode buxhetore pasi që kemi 58,000€ mjete në participim në projekte, por Drejtori po thotë se ju duhet ta aprovoni, e si me aprovu na si të thuash ti?, ne si antarë të Kuvendit i kemi propozimet tonë po e dim se është marrë me thënë ndriqim publik 5,000€ në Pasjak por i kemi ndarë në mandatin e parë 19,000€ buxhet për ndriqimin në fshatin Pasjak dhe nuk e dim se ku janë mbetur ato mjete dhe ju si Drejtor duhet të jepni llogari.

Xhejlane Behluli pasi pershendeti të pranishmit tha: pajtohem pjesërisht me listen e propozuar nga zv.kryesuesi por çka nuk pajtohem është se nuk e di se me kënd jeni konsultuar sa i përket ndriqimit në fshatin Pasjak, si me u rregullu ndriqimi ka pjesë e burgut kur prej fillimit të fshatit mungon, mu duk e palogjikshme kur e degjova këtë propozim por duhet të fillohet prej fillimit të rrugës e mandej në vitet e ardhshme sipas buxhetit pjesë e tjera të fshatit pasi që Pasjaku është duke u rritur shumë me teritor. Çka nuk jam e kënaqur është edhe me ndarje të shumës për rrugën në fshatin Makresh 30,000€ janë pak për asfaltimi, është e drejtë e imja me kërku për ata banorë dhe kërkoj të bëhet një ndryshim një rritje e shumës të bëhet 100,000€ pasi që 30,000€ janë pak, ju faleminderit.

Dobrivoje Djordjevic tha: po kthehem në propozimin tim që të bëjmë një pauzë pasi që unë nuk pajtohem me asnjë nga propozimet tuaja, prioriteti është rruga në fshatin Stanishor pasi është në një gjendje katastrofike.

Kryesuesi tha: siç i keni degjuar propozimet e Ramushit si dhe propozimet e Bajrushit të gjitha janë kërkesa të qytetarëve që i kanë paraqitur atë ditë në debat publik, bëjmë një pauzë prej 5min dhe kthehemi pastaj.

Pas pauzes Kryesuesi tha: vazhdojmë me diskutime nëse paraqitet dikush.

Selatin Nuhiu pasi pershendeti të pranishmit tha: sa i përket buxhetit për investime kapitale të gjithë po e kuptojmë dhe po themi se është një buxhet shumë i vogël por ne jemi munduar që ti zgjedhim prioritetet e qytetarëve, për fshatin Makresh i cili u përmend disa herë ne jemi iniciator të cilet e kemi propozuar këtë projekt dhe ne se paku po ja fillojmë, dikush nuk e ka filluar hiq dhe e dim se ai është nënqim dhe janë pak mjete për atë projekt por ne kryesore po ja fillojmë këtij projekti, ju faleminderit.

Bajrush Ymeri tha: kur ne kemi bërë diçka për atë fshat, ti se ke ditur që egziston, unë më duket se shumë i qartë isha, nuk e propozova unë por këto propozime kanë dalë prej përfaqësuesve të fshatrave ne debat, unë nuk propozova asgjë vetëm se thashë në debat kanë qenë propozimet e tilla nuk ka rëndësi se a e propozon Selatin, Bajrush, Ramushi apo kush e propozon ne e përkrahim çdo kërkesë që vjen për qytetarët, e kërkojmë një pauzë dhe ne nuk bëjmë asgjë dhe ska mundësi me u bë kurgjo për arsye se çdo vendim që mirret në presion nuk është vendim i drejtë, është dashtë që menjëher pas debatit që e kemi pasur atë ditë këtu, është duhur të nesërmen të organizohet një punori nga Kuvendi me përfaqësuesit e fshatrave, ekzekutivi dhe me shikim se cila është lista e kërkesave dhe tju dhëjmë prioritet se cila rrugë ka më së shumti nevojë, ndriqimit që ka më së shumti nevojë si dhe ujësjellësit që është i nevojshëm dhe kanalizimit, më pastaj e aprovojmë, e jo dikujt me ja realizu të gjitha e dikujt asgjë. P.sh fshati Kufc të gjithë e dini që 10 vite përveq rrugës kryesore asgjë nuk është investuar aty, unë nuk kam pasur mundësi sa kam qenë në mandatin tim, me atë buxhet që e kemi pasur jemi mundur të realizojmë shumë, andaj po ju them se ju sot mundeni me votu por në këtë formë po krijoni paknaqësi mes qytetarëve, ju faleminderit.

Kryesuesi tha: në fshatin Kufc është rregulluar ndriqimi, trotuari, kanalizimi dhe ujësjellësi nuk është gjendja ashtu si thatë ju.

Xhejlane Behluli tha: shumë mirë na tregoj edhe Nënkryetari i Komunës, Kryetarin po e ngelizhoni pasi po ju neglizhoni edhe ai po thuani ju por keni pasur mundësinë me u taku me përfaqësuesit e fshatrave këtu në Kuvend dhe me i caktu prioritetet, mirëpo këtu po shihet shumë mirë prej përvijes së kaluar që janë

votuar projektet, qellimin e kanë të njëjt por ne të kunderten po e bëjmë prej mandatit të kaluar po e perkrahmi, qellimin e keni të merni poena politik por ju kuptoj shumë mirë pasi që politik është kjo mirëpo jo veç ju ku po mendoni, thash që jam pjesërisht e knaqt me propozimet, çka nuk jamë e knaqur me pjesëmarrjen e qytetarëve serb në degjim publik dhe nuk ka qenë asnjë propozim perveq Drejtorit i cili ka propozuar për fshatin Kufc, unë kam qenë pjesëmarrëse në të gjitha debatet publike ka qenë edhe Kryetari Svetislav Ivanovic dhe i di të gjitha kërkesat e qytetarëve, andaj nuk jam e knaqur me propozimet e Ramushit, me të vertet janë qesharake. Mirë e tha Nenkryetari po doni mi votu votoni unë jam kunder projektit në Pasjak dhe projektit në Makresh kunder shumave të buxhetit që i keni propozu ju, le të jetë edhe në procesverbal pasi që po i shfrytëzoni këto bisedat e tona në qytetarë, ju faleminderit.

Dobrivoje Djordjevic tha: të gjithë e dim se Komuna nuk mundë ti realizoj të gjitha kërkesat e qytetarëve për një vit por le të jen prioritete edhe për vitet e tjera, nuk është reale që thuhet se unë nuk kam asnjë propozim pasi që të gjithë i kemi propozimet dhe kërkesat që i kemi paraqitur edhe më heret, të caktohen projektet prioritare për vitet e ardhshme që të realizohen.

Sercan Todorovic tha: gjysma e projekteve të Ramushit nuk mundë të realizohen, fillimisht duhet të bëhet vlersimi i projektit se sa kushton nuk ka mundësi që me 10,000€ ose 5,000€ të realizohet i gjithë projekti. Ne nese kemi donacione mundë të participojm por edhe nga kjo shumë i keni terhejur disa mjete.

Ramush Mehmeti tha: po pajtohem me Drejtorin që po thot se nuk ka shumë mjete ne po e dim që më keto shuma nuk asfaltohet një rrugë, por ne më kete vendim sot po i ndajm kodet buxhetore me mundësi participimi që të perfundoj i gjithë projekti, unë nuk kam propozuar këtë list por bashkarisht po e propozojm nese pajtoheni e kalojm mos të marrmi kohë me teper, lista e projekteve jam shumë i sikurt se është legjitime, ju faleminderit.

Zymer Zymeri tha: 3,000€ që janë propozuar për fshatin Koznic për ndriqim ose të rregullohet ndriqimi te të tri mahallet ose mos të rregullohet hiq, unë nuk po propozoj në emer të LDK-së por në emer të popullit. Ktu nuk ka faj populli pasi që Kryetari e ka pru Komunen në këtë gjendje me lu çdo asambleist, çdo investim në rrugë e uj duhet ta ket kodin e vet se cila rrugë dhe ku po asfaltohet.

Abdyl Gashi tha: mendoj se propozimet të cilat i kemi dhënë në bashkpunim më Ramushin dhe antarët tjerë janë të arsyeshme dhe mendoj se prej propozimeve që i kanë dhënë qytetarët janë zgjedh ato me thelbesore dhe jetike për qytetarët dhe mendoj se është koha me kalu në votim.

Xhejlane Behluli tha: nese e sheh bazike dhe jetike mu ndriqu fshati Pasjak në atë pjesë që nuk ka asnjë banorë ka burgu atëher e perkrahi mendimin tond shumë të gabuar pasi që duhet patjter për arsye të projekteve të tjera të perkrahet edhe ky por unë jam kunder shumës që është nda.

Drejtori i Administrates Driton Andyli pasi pershendetit të pranishmit tha: nuk është këtu prej fillimit, buxheti i propozuar prej Kryetarit duhet me cek cila rrugë, cili projekt. Nuk është në rregull me u maltretu qytetarët e mi than hajdi shikoni se çka bëjmë ne, nuk është fer, as nuk kemi me fitu ne pa ju po as ju pa ne. Në po e votojm listen por duhet të merrni pergjegjësi Ramush Mehmeti para këtyre qytetarëve që kjo list te realizohet, a ju ke tregu njerzve që edhe ne nese e votojm është dikush tjer që ka mundësi mos me nenshkr, prandaj është dasht ne me shku të Kryetari dhe mi than se ne e kemi bërë këtë list dhe po dojm me u kry kjo punë dhe me ardh edhe Kryetari me ju me propozu, çka bojm nese Kryetari nuk e nënshkrun. 2 milion i kemi investuar në vitin 2010 dhe si kemi kryer të gjitha problemet dhe nuk kryehen asnjëher. Si dhe nuk po muj me kuptu se qysh po intervenon në kodin e pagave dhe meditjeve se po thu mbetni pa rroga, askush nuk mbet pa rrogë ato mjete dalin nga Ministria si dhe në zhvillim ekonomik ndoshta kan palinifikuar që të marrin edhe puntorë të tjerë.

Ramush Mehmeti tha: pajtohem me ty plotësishtë por Drejtorit i Financave nuk tha se kan planifikuar puntorë të tjerë, mos të keqkuptohemi Kuvendi e merr propozimin e vet nese kalon në rrëgull por pergjegjsin nese nuk e nënshkrun Kryetari nuk e merr askush.

Sercan Todorovic tha: sa i perket pagave qarkoren buxhetore e marmi nga Ministria e Financave.

Kryesusi tha: e kemi propozimin e Ramush mehmetit për hapje të kodeve të reja për fushen e sportit ne Kufc dhe thurjen e mirëmbajtjen e varrezave e hudhi në votim këtë propozim.

## Procesverbali i Kuvendit

Me 11 vota për, 1 apstenim dhe 1 nuk ka votuar aprovohet vendimi për hapje të kodeve të reja.  
Kryesusi tha: kalojmë në listen e projekteve dhe e hudhi në votim listen e propozuar sot në mbledhje.  
Sercan Todorovic tha: duhet ta hudhni në votim propozim Buxhetin për vitin 2020-2022.

Kryesusi tha: e hudhi në votim listen e projekteve.

Me 10 vota për, 2 kunder (Jorgovanka Filic, Negovan Jovanovic) dhe një astenim aprovohet lista e projekteve.

Kryesusi tha: e hudhi në votim buzhetin me këto ndryshime dhe me këtë listë të projekteve.

Me 11 vota për, 1 apstenim, 1 nuk ka votuar aprovohet Buxheti për vitin 2020-2022 dhe bihet ky:

### VENDIM

Për aprovimin e buxhetit për periudhën 2020/22.

**Pika e tretë:** Të ndryshme.

Pasi nuk pat diskutime tjera Kryesuesi i falenderoi të pranishmit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 11:30.

Valmire Mustafa  
Procesmbajtëse



Nebojsa Arsic  
Kryesues i Kuvendit

